



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “TEKSTIL-KONFEKSIONE”
(Mbështetur në kualifikimin profesional “Konfeksione NABER-ADA”)

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Tekstil-konfeksione**” mbështetur në Kualifikimin Profesional “Konfeksione NABER-ADA”, me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Konfeksione NABER-ADA, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe klasa e 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Tekstil-konfeksione”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Tekstil- konfeksione**” mbështetur në Kualifikimin Profesional “Konfeksione NABER-ADA”, do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth **30%** të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Tekstil- konfeksione**” mbështetur në Kualifikimin Profesional “Konfeksione NABER-ADA”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Njohuri mbi shabllonet e prerjes, kl. 10 dhe kl. 11.
2. Makineritë në industrinë e veshjeve, kl. 10 dhe kl. 11.
3. Materialet e konfeksioneve, kl. 10 dhe kl. 11.
4. Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve kl. 13.

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Njohuri mbi shabllonet e prerjes	88	36
2	Makineritë në industrinë e veshjeve	67	27
3	Materialet e konfeksioneve	76	31
4	Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve	13	6
	TOTALI	244	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- 1) “Njohuri mbi shabllonet e prerjes”, kl. 10 dhe kl. 11: (88 orë)**
- Tabelat e përmasave, njohuri të përgjithshme 4 orë
 - Tabelat e përlogaritjes së masave të veshjeve për femra 6 orë
 - Konstruksioni i shablloneve bazë të prerjes së fundit për femra 8 orë
 - Konstruksioni i shablloneve bazë të prerjes së bluzës për femra 10 orë
 - Konstruksioni i shablloneve bazë të prerjes së mëngëve të bluzës për femra 8 orë
 - Konstruksioni i shablloneve bazë të prerjes së pantallonave standarde për femra 10 orë
 - Terminologjia teknike e krijimit të shablloneve për femra dhe meshkuj 4 orë
 - Konstruksioni i shabllonit bazë të prerjes së fustanit me pensa në bel 4 orë
 - Shabllonet bazë të prerjes së jakave për bluza dhe fustane 6 orë
 - Mënyrat e zhvendosjes së pensave në pozicione të ndryshme 6 orë
 - Shabllonet bazë të prerjes së këmishës për femra 6 orë
 - Shabllonet bazë të prerjes së këmishës për meshkuj 8 orë
 - Shabllonet bazë të prerjes së pantallonave standard për meshkuj 8 orë
- 2) “Makineritë në industrinë e veshjeve”, kl. 10 dhe 11: (67 orë)**
- Historiku i zhvillimit të makinave qepëse 2 orë
 - Klasifikimi i makinerive dhe pajisjeve në industrinë e veshjeve 2 orë
 - Ndërtimi, funksionimi i makinave të qepjes industriale (me 1 gjilpërë) 9 orë
 - Ndërtimi, funksionimi i makinave të qepjes industriale (me 2 gjilpëra) 9 orë
 - Ndërtimi, funksionimi i makinave qepëse syzator (me 3 dhe 5 fije) 7 orë
 - Njohuri mbi makinat e proceseve ndihmëse 6 orë
 - Njohuri mbi përgatitjen dhe përdorimin e makinave hekurosësh 4 orë
 - Njohuri mbi makinat e qëndisjes 4 orë
 - Proceset e përgatitjes për punë të makinave të qepjes industriale me një dhe dy gjilpëra 6 orë
 - Defektet dhe mënyrat e rregullimit të tyre në makinat qepëse me një dhe dy gjilpëra 8 orë
 - Defektet dhe mënyrat e rregullimit të tyre në makinat qepëse syzator 6 orë
 - Njohuri mbi makinat e qepjes së trikotazheve 4 orë
- 3) “Materialet e konfeksioneve”, kl. 10 dhe 11: (76 orë)**
- Klasifikimi i fibrave tekstile 4 orë
 - Karakteristikat bazë të strukturës së fibrave tekstile 4 orë
 - Përcaktimi, përbërja dhe sjellja ndaj reagjentëve kimikë të fibrave të pambukut

- Përcaktimi, përbërja dhe sjellja ndaj reagentëve kimikë të fibrave të lirit, kërpit dhe jutës 6 orë
- Klasifikimi i fibrave të leshit, përbërja dhe sjellja ndaj reagentëve kimikë 6 orë
- Filaturimi i fijeve tekstile 6 orë
- Prodhimi i pëlhurës 8 orë
- Përpunimi i pëlhurave 6 orë
- Përcaktimi, karakteristikat e fijes së trikotazhit 6 orë
- Llojet e thurjeve të trikotazheve dhe karakteristikat e tyre 8 orë
- Vetitë e trikotazheve sipas llojit të thurjeve 6 orë
- Teknologjia e prodhimit të lëkurave 5 orë
- Llojet e lëkurave dhe përdorimi i tyre 5 orë

4) “Organizimi dhe legjislacioni në industrinë e tekstil-konfeksioneve”, kl.13: (13 orë)

- Organizimi i punës 2 orë
- Organigrama e ndërmarrjes 2 orë
- Sistemi i organizimit të prodhimit 3 orë
- Biznesi i vogël 2 orë
- Format ligjore të pronësisë dhe çështjet e taksimit 4 orë